

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN  
E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN  
E TË DHËNAVE PERSONALE

# PRIVATËSIA DHE SIGURIA E TË DHËNAVE PERSONALE

GJATË PËRDORIMIT TË RRJETEVE SOCIALE  
NGA GRUP-MOSHA 15-18 VJEÇ

Studim



Tiranë, dhjetor 2016

**Studimi u përgatit nga  
Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit  
dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale**

**Irma Arapi  
Alketa Koja  
Redi Skënderaj  
Erald Mullaraj**

Tel.: +355 42237200  
Nr. Jeshil: 0800 2050  
[www.idp.al](http://www.idp.al)

# Përmbajtja

HYRJE	5
REZULTATET E STUDIMIT	9
KONKLUZIONE	27
BIBLIOGRAFIA	30
KËSHILLA PËR MBROJTJEN E PRIVATËSISË	31



KOMISIONERI PËR TË DREJTËN  
E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN  
E TË DHËNAVE PERSONALE

## Hyrje

Zhvillimi i shpejtë i teknologjisë së informacionit ka sjellë në dekadat e fundit ndryshime radikale në çdo aspekt të jetës. Shoqëria e informacionit bazohet në prodhimin e pakufishëm dhe të pandalshëm të informacionit. Fëmijët e sotëm, të të gjithë moshave, kanë lindur dhe po rriten në një kohë kur përdorimi i kompjuterit, interneti, komunikimi online, media sociale janë të aksesueshme dhe të përdorura nga të gjithë grup moshat dhe shtresat sociale. Komunikimi në rrjete sociale dhe nëpërmjet aplikacioneve të shkarkueshme në telefon janë mënyra më e zakonshme dhe komunikimit virtual të fëmijëve.

Sot jemi në prag të një shpërthimi të ri të teknologjisë së informacionit dhe robotikës. Interneti i gjërave (IoT), Inteligjenca Artificiale (AI), Realiteti Virtual (VR) dhe Virtualitetet e Shtuara (AR) janë disa nga risitë e fundit të teknologjisë së avancuar, të cilat do të kenë një ndikim shumë të madh tek brezat e ardhshëm.

Këto zhvillime teknologjike dhe komunikuese krijojnë forma sjelljeje, të cilat ne, të rriturit, duhet t'i njohim, t'i kuptojmë si dhe t'i përgatisim të rinjtë për rreziqet që mund të shfaqen. Ky studim, së bashku me aktivitete të tjera që Zyra e Komisionerit ka organizuar ndër vite, ka në fokus pikërisht ndërgjegjësimin e nxënësve, mësuesve dhe prindërve në edukimin për mbrojtjen e të drejtave themelore dhe veçanërisht të drejtës për një jetë private gjatë komunikimit online. Me rastin e 10-vjetorit të 28 janarit, Ditës Evropiane të Mbrojtjes së të Dhënave Personale, Zyra

e Komisionerit ndërmori iniciativën e realizimit të një fushate për ndërgjegjësimin e nxënësve të shkollave të mesme në lidhje me përdorimin e rrjeteve sociale dhe kujdesin për mbrojtjen e privatësisë. Përfaqësuesit e Zyrës së Komisionerit bashkëbiseduan me nxënësit e 36 shkollave të mesme të Shqipërisë, ku diskutuan mbi praktikën e përdorimit të rrjeteve sociale, ekspozimit të jetës private në to, rëndësinë e sigurisë online dhe mbrojtjen e të dhënave personale ndaj rreziqeve online.

Materialet e vëna në dispozicion nga përfaqësuesit e Zyrës së Komisionerit si fletëpalosje, prezantimet mbi mbrojtjen e privatësisë në internet, udhëzuesi për publikimin e fotografive dhe siguria e të dhënave personale, rritën ndërgjegjësimin e nxënësve për tematikat e trajtuara.

Këto takime i dhanë mundësinë Zyrës së Komisionerit të realizonin një studim nëpërmjet 1063 intervistave të realizuara me nxënësit e 36 shkollave të mesme të përgjithshme të qyteteve të Tiranës, Durrësit, Vlorës, Elbasanit, Fierit, Beratit, Gjirokastrës, Lezhës, Shkodrës, Korçës, Kukësit, Lushnjës, Sarandës, Tepelenës, Përmetit dhe Pogradecit.

Grupmosha e përfshirë në këtë studim është nga 15 deri në 18 vjeç. Nxënësit janë intervistuar vullnetarisht dhe në mënyrë anonime, pasi të ishin informuar paraprakisht për qëllimin e realizimit të tij nga përfaqësuesit e Zyrës së Komisionerit. Mesatarja e nxënësve të intervistuar është 29 nga çdo shkollë, rreth 40 pjesëmarrës mesatarisht në secilin prej takimeve të realizuara në këto institucione arsimore. Numri më i madh i pjesëmarrësve në këtë pyetësor jetojnë në qendra të zhvilluara urbane, më të mëdhatë e vendit, me disa përjashtime në ndonjë shkollë në Tiranë dhe në Kukës.

Në këtë studim, krahas analizës së të dhënave të përfituar nga intervistat e nxënësve të shkollave të mesme të Shqipërisë do të jepet dhe një analizë krahasuese me të dhënat e studimeve të kryera më parë në Shqipëri dhe në vendet e tjera, kryesisht ato evropiane.

Objektivi i këtij studimi është të kontribuojë në një analizë të përditësuar të gjendjes së përdorimit të komunikimit online dhe kryesisht të komunikimit nëpërmjet rrjeteve sociale nga ana e adoleshentëve shqiptarë, nga perspektiva e mbrojtjes e të drejtës themelore - ajo e mbrojtjes së privatësisë. Ky studim dëshiron t'ju vijë në ndihmë të gjithë autoriteteve shtetërore, sidomos atyre që operojnë në fushën e arsimit, në mbështetje të hartimit të politikave dhe dokumentave strategjike për një mbrojtje më efikase të jetës private dhe të dhënave personale të nxënësve.

Ky studim është edhe një kontribut i Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale për zbatimin e “Rezolutë për Miratimin e një Kuadri Ndërkombëtar Aftësimi mbi Edukimin e Privatësisë për Nxënësit e Shkollave”, e cila u miratua në edicionin e 38-të të Konferencës Ndërkombëtare të Komisionerëve të Mbrojtjes së të Dhënave dhe Privatësisë në tetor 2016. Që prej vitit 2014 Zyra e Komisionerit është pjesë e Grupit të Punës mbi Edukimin Digjital, i miratuar në vitin 2013 në Varshavë në Konferencën Ndërkombëtare të Komisionerëve të Mbrojtjes së të Dhënave Personale dhe Privatësisë. Si pjesë e këtij Grupi Pune, Zyra e Komisionerit ka kontribuar në hartimin e dokumentit “Kuadri Ndërkombëtar - Aftësimi mbi Edukimin e Privatësisë për Nxënësit e Shkollave”. Ky dokument do të promovojë përdorimin dhe zhvillimin praktik të kuadrit të kompetencave mbi edukimin e privatësisë, si pjesë e programeve studimore apo kurrikulave dhe trajnimin e mësuesve, pavarësisht disiplinës së ushtruar.

Zyra e Komisionerit dëshiron të falënderojë për mbështetjen gjatë realizimit të këtij studimi të gjithë drejtuesit e drejtorive arsimore në qarqe, drejtuesit e shkollave dhe stafet pedagogjike.

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale do të vazhdojë të trajtojë me prioritet edukimin e grupmoshave të reja me parimet e mbrojtjes së privatësisë, të bindur për domosdoshmërinë e rritjes së një brezi të ri të informuar dhe të aftë për sfidat e kohës.



## Rezultatet e studimit

Sipas një studimi të botuar në vitin 2015 nga Open Data Albania përdorimi i internetit në Shqipëri ka pësuar rritje. Në harkun kohor të pesë viteve (2010-2014) numri i pajtimtarëve me akses broadband nga rrjete fikse është rritur 72%. Pajtimtarët e internetit 3G nga ana tjetër janë rritur me mbi 400% në harkun kohor 2011-2014. Kjo rritje e jashtëzakonshme ka ardhur falë futjes së teknologjisë 3G, me të cilën ofrohet shërbimi i internetit edhe në telefonat celularë.

Vendet kandidatë për në BE	Numri i përdoruesve të internetit 30 Qershor 2016	Penetrimi i internetit në popullsi (%)
Shqipëri	1,823,233	60.00%
Bosnjë-Hercegovina	2,628,846	68.10%
Kosova	1,523,373	80.90%
Maqedonia	1,439,089	68.50%
Mali i Zi	388,057	60.20%
Serbia	4,758,861	66.60%
Turqia	46,196,720	57.50%
<b>Totali (Vendet kandidatë)</b>	<b>58,758,179</b>	<b>59.40%</b>

Tab. 1 Të dhënat e marra nga <http://www.internetworldstats.com>

Gjithashtu, të dhënat e publikuara nga Portali Statistics.com tregojnë se, në muajin qershor 2016, Shqipëria kishte mbi 1.8 milionë përdorues të

internetit, me një nivel penetrimi 60% të popullsisë, që, krahasur me të dhënat e vendeve të tjera të rajonit dhe kandidatë për anëtarësim në Bashkimin Evropian, është pak më shumë se mesatarja e përbashkët.


Ndërkaq, të dhënat e tre mujorit të tretë të vitit 2016 të publikuara nga Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) tregojnë se numri i qytetarëve shqiptarë me akses në internet, është në rritje. Nga të dhënat e krahasuara me një vit më parë, vihet re se numri i përdoruesve të internetit me linjë fikse është rritur me 13,9%, ndërsa numri i atyre që përdorin rrjetin 3G dhe 4G nëpërmjet telefonit celular është rritur me 51,3%.

Shërbimet e Internetit	QIII 2016	Ndryshim vjetor QIII 2016-QIII 2015
Numri i pajtimtarëve me akses broadband fiks (linja)	261,747	13,9%
Numri i pajtimtarëve me akses broadband 3G/4G	1,833,231	48,3%
Nëpërmjet aparatit të telefonit celular	1,708,745	51,3%
Nëpërmjet cards/modem/keyes (jo aparate celulare)	124,486	17,1%

Tab. 2 Të dhënat e marra nga faqja zyrtare e AKEP <http://akep.al/statistika>


Ndërkaq, nga përpunimi i të dhënave të studimit “Privatësia dhe siguria e të dhënave personale gjatë përdorimit të rrjeteve sociale” evidentohet se, vetëm 5% e nxënësve përdorin kompjuterin personal për t’u lidhur në internet, përkundrajt 29% të moshatarëve të tyre të cilët përdorin vetëm aparatin celular për të njëjtin qëllim.

Ndërkohë, që 64% e nxënësve deklarojnë se aksesin në internet e kanë nëpërmjet të dy pajisjeve, pra PC dhe telefonin celular. Ndërsa, vetëm 7% e të pyeturve deklarojnë se përdorin tabletin për t’u lidhur në internet.



Lidhja e adoleshentëve me aparatin celular është mëse e kuptueshme, duke konsideruar faktin se telefonat e gjeneratës së fundit, siç janë të ashtuquajturit smartphone, ofrojnë një shumëllojshmëri funksionesh dhe mundësish për komunikim, argëtim dhe informacion që disa vite më përpara ishin të paimagjinueshme.

Nga nxënësit e intervistuar 96% e tyre deklarojnë se kanë të paktën një llogari në një rrjet social, ndërsa vetëm 4% e tyre pranuën, se nuk ishin pjesë e asnjë rrjeti social. Ky rezultat është deri diku befasues për shkallën e lartë të interesit të adoleshentëve shqiptarë për komunikimin nëpërmjet rrjeteve sociale, duke krahasuar me studimet e bashkëmoshatarëve të tjerë evropianë.



Një studim i kryer nga qendra EUKIDSONLINE ([www.eukidsonline.com](http://www.eukidsonline.com)) fillimisht në vitin 2010 dhe i përsëritur më pas në 7 shtete (Belgjikë, Danimarkë, Itali, Irlandë, Portugali, Rumani dhe Mbretëri e Bashkuar) në vitin 2014 “Net Children Go Online” rezultoi se 63% e fëmijëve të moshë 11-16 vjeç kishin një llogari në një rrjet social.


Arsyet e kësaj prirjeje mund të lidhen me zgjerimin e mundësive teknike, duke filluar nga përdorimi i gjerë i telefonave të zgjuar

(smartphone), uljen e kostos së shërbimit të internetit por aq edhe me shkaqe psikologjike si predispozita e shoqërisë sonë për të komunikuar me të njohur dhe më pak të njohur.

Nga grafiku i mëposhtëm vihet re se rrjeti social më i përhapur tek adoleshentët shqiptarë është Instagrami. Ky rrjet social përdor kryesisht fotografinë si mjet komunikimi dhe në masë më të vogël videon. Instagrami është mjaft popullor tek të rinjtë kudo në botë dhe duket se kjo tendencë globale për komunikim ndiqet edhe tek të rinjtë shqiptarë.

Dëshira për të komunikuar nëpërmjet imazheve vihet re dhe në preferencën e të rinjve për të përdorur një rrjet të ri, siç është Snapchat-i. Me më pak se dy vjet nga suksesi i tij botëror, ky rrjet, i cili mjetin kryesor të komunikimit ka shkëmbimin e videos, ka zënë vendin e tretë me 51% të adoleshentëve, të cilët kanë hapur një llogari në këtë rrjet.


Kjo tendencë duket të jetë në linjë me tendencat e preferencave të moshatarëve kudo nëpër botë, të cilët gjejnë më të lehtë dhe më argëtuese komunikimin mes miqsh nëpërmjet imazheve dhe videoeve.



Grafiku 3

Kjo prirje vihet re dhe nga fakti se rrjeti social më i përhapur në botë, Facebook, me më shumë se 1.7 miliardë përdorues zë vendin e dytë në preferencat e të rinjve shqiptarë, ndërsa twitter zë vendin e gjashtë. Është për t'u vënë në dukje se, mbi 30% e të rinjve përdorin rrjete më pak të njohura, por të cilat përshtaten me preferencat dhe pasionet personale. Disa nga rrjetet më të përmendura janë Pinterest, Tumblr, Vine, We tirk, Ask.fm, Wish.com, KIK, 500px, Stardoll, We heart it, Candiid, Phhphoto, etj.


Kjo tendencë e adoleshentëve shqiptarë për të komunikuar nëpërmjet rrjeteve sociale, vihet re edhe në grafikun nr. 4, në lidhje me numrin e rrjeteve sociale që ka në përdorim secili prej tyre. Nga të dhënat e këtij grafiku rezulton se vetëm 13% e tyre ka të paktën 1 profil në një rrjet social, ndërsa grupi më i madh i nxënësve prej 71% ka minimumi 2 profile në rrjete sociale dhe maksimumi 5. Një pjesë tjetër e tyre, prej 16%, kanë deklaruar se janë të anëtarësuar në më shumë se 5 rrjete sociale.



Grafiku 4

Anëtarësimi në shumë rrjete sociale duket si një sjellje varësie, e ngjashme me sjelljet patologjike dhe devijimet psikologjike. Këto efekte psikologjike të cilat prekin fëmijët online mund të sjellin reagime psikologjike si frika, ankthi, keqardhja, dëshira etj., të cilat ndikojnë drejtpërdrejtë në jetën e tyre reale.

Pothuajse gjysma e të pyeturve ose 48%, deklarojnë se e përditësojnë profilin e tyre në rrjetin social disa herë në ditë, duke vendosur foto, video, statuse, informacione apo të gjitha bashkë. Duke analizuar shifrat, përqindja e atyre, që e përditësojnë në mënyrë të shpeshtë profilin online (duke konsideruar kategoritë që e bëjnë përditësimin disa herë në ditë, vetëm një herë në ditë dhe disa herë në javë) përbën 2/3 e nxënësve të intervistuar, pra 75% e tyre. Që prej viteve 90-të, në bibliografinë e studimeve psikologjike dhe psikiatrike janë përfshirë temat e sjelljeve të varësisë dhe përdorimit jonormal të kompjuterit dhe internetit. Kohët e fundit këtyre studimeve i janë shtuar dhe studimet e sjelljeve patologjike të përdorimit të rrjeteve sociale.



Grafiku 5

Sipas studimit të publikuar nga Autoriteti Hungarez për Mbrojtjen e të Dhënave Personale “Mbi përdorimin e sigurt dhe të ndërgjegjshëm të internetit nga ana e fëmijëve”, literatura e kohëve të fundit të psikologjisë ka analizuar impaktin e fenomenit Facebook në marrëdhëniet njerëzore, personalitetin e individit si dhe ndryshimet e strukturave të shoqërisë. Teknika të reja moderne po përdoren nga ekspertët se si sjellje të ndryshme online influencojnë segmente të ndryshme të trurit. Po si këto sjellje ndikojnë tek fëmijët?


Diçka është e sigurt, se gjithmonë e më shumë fëmijët, adoleshentët dhe të rinjtë shqiptarë përdorin komunikimin online, kjo falë dhe përdorimit gjithmonë e më masiv të telefonave celular, të cilat kanë zëvendësuar kompjuterat statik dhe ata personal dhe se duhet të ketë një ndërgjegjësim gjithmonë e në rritje të familjarëve, mësuesve dhe aktorëve institucional për t’i paraprirë probleme të ndryshme që mund të shfaqen në horizont.

Rëndësia e mbrojtjes së privatësisë dhe sigurisë së të dhënave personale gjatë përdorimit të rrjeteve sociale është e lidhur ngushtë me disa praktika të përdorimit të këtyre të fundit nga ana e adoleshentëve. Numri i miqve në rrjetin social, njohja e tyre edhe në jetën reale, si dhe njohuritë teknike për mbrojtjen e privatësisë gjatë përdorimit të profilit social janë disa nga indikatorët e treguesit të rrezikshmërisë së privatësisë dhe sigurisë online.

Sa më shumë informacion ndahet në rrjetet sociale, sa më shumë miq të vërtetë ose jo të jenë të përfshirë në këto profile sociale aq më e madhe është mundësia e abuzimit me të dhënat personale. Kështu, pyetjes se sa miq keni në profilin tuaj, 45% e tyre pranojnë se kanë më pak se 200 miq; ndërsa, më shumë se gjysma, saktësisht 55% e të pyeturve, kanë




mbi 200 miq virtualë. Ajo çka vihet re nga grafiku i mëposhtëm, është një tendencë për të patur sa më shumë miq, duke sjellë në vëmendje faktin se kategoria e nxënësve që ka më shumë se 500 miq, përbën 27% të totalit, kundrejt 17% të nxënësve, që kanë më pak se 100 miq virtualë.



Grafiku 6

Një studim i vitit 2011, i kryer nga qendra britanike EU Kids Online me titull “Social networking, age and privacy” tregoi se 38% e fëmijëve të moshave 13-16 vjeç të 26 vendeve të Bashkimit Evropian kishin më shumë se 100 miq në profilin e tyre social. Ndërsa, një studim i vitit 2013 në Hungari evidentoi se 33% e fëmijëve nga mosha 9-13 vjeç kanë 100 deri në 300 miq në rrjetin social dhe 13% e tyre kanë më shumë se 300 miq.


Nxënësit e intervistuar komentojnë se arsyeja kryesore e përdorimit të rrjeteve sociale është për të kontaktuar me familjarë dhe miq. Kjo ndodh për 83% të të intervistuarve. 66% e tyre deklaron se i përdor të dhënat personale për të gjetur informacion dhe 49% për të ndarë video/foto/muzikë mes miqsh. Edhe pse një rëndësi pak më të vogël merr ndarja e komenteve dhe njohja e miqve të rinj, ajo përsëri është e rëndësishme për këtë grupmoshë, pasi pothuajse 1/3 e tyre i përdor rrjetet sociale për këto qëllime. Në renditjen e këtyre preferencave, në pozicionet e fundit renditen lojrat online dhe dhënie e eksperiencës personale. E rëndësishme të evidentohet në këtë studim është përqindja e atyre nxënësve që e përdorin rrjetin social për të njohur miq të rinj. Kështu 27% e të intervistuarve deklarojnë se e përdorin profilin e tyre social për këtë qëllim.



Grafiku 7

Njohja e miqve të rinj nëpërmjet rrjeteve sociale, pa i njohur më parë në jetën reale, është një sjellje e cila prek drejtpërsëdrejti jetën private të fëmijëve dhe mund të sjellë pasoja negative për të cilat kjo grupmoshë nuk është mjaftueshëm e vetëdijshme.


Nga takimet me nxënësit, por edhe si rezultat i përgjigjeve të dhëna në pyetjen “A i njihni të gjithë miqtë tuaj në rrjetet sociale?”, diçka më pak se gjysma e tyre, ose 48%, pranon se i njihni të gjithë. Ndërsa, 43% deklarojnë se njohin disa ose pjesën më të madhe të miqve në rrjetin social që përdorin, ndërsa 8% e tyre deklarojnë se njohim vetëm disa prej miqve. Nga shifra e fundit kuptojmë tendencën e të rinjve për sa më shumë njohje dhe komunikim nëpërmjet rrjeteve sociale dhe njëkohësisht edhe tendencën e tyre për të bërë miqësi të reja online. Kjo përbën një faktor rreziku për jetën private dhe të dhënat personale, të cilat mund të keqpërdoren duke u kopjuar, ripunuar, publikuar dhe përdorur për qëllime nga më të ndryshmet, përfshirë këtu kërcënime, sjellje agresive, shantazhe, etj.



Grafiku 8

Komunikimi online me të panjohur është një nga faktorët kryesor i cili rrit nivelin e rrezikshmërisë së përdorimit të rrjeteve sociale, kryesisht nga fëmijët. Një studim i vitit 2014 i zhvilluar nga organizata World Vision Albania, e cila ka intervistuar 900 fëmijë shqiptarë të grupmoshës 13-18 vjeç, ka evidentuar se 47% e kësaj grupmoshe janë kontaktuar online nga një individ në vitin e fundit.


Në intervistat e zhvilluara nga Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale gjatë periudhës janar-dhjetor 2016, 32% e nxënësve, ose rreth 1/3 e tyre pranojnë se kanë takuar një mik, të cilin e kanë njohur fillimisht gjatë një komunikimi online në një rrjet social.



Grafiku 9

Njohja në rrjete sociale ku mundësia për t'u fshehur pas një profili të rremë është shumë e lartë. Kjo kërkon që fëmijët, nxënësit, mësuesit, psikologët e shkollave dhe prindërit të fillojnë një diskutim të gjerë mbi këtë temë, për t'u ndërgjegjësuar rreth rreziqeve që kjo praktikë mund të sjellë në jetën reale.


Përdorimi i rrjeteve dhe profilit social duket se nuk është një kalim kohe pa probleme, pasi rreth 2/3 e nxënësve të pyetur, saktësisht 66% e tyre, deklarojnë se kanë patur probleme me miqtë virtualë duke qenë viktimë e ofendimeve dhe komenteve fyese.



Ky numër i lartë i nxënësve që ka hasur ofendime dhe komente fyese gjatë komunikimit online në profile sociale është një tregues rreziku, i cili gjithashtu duhet marrë në konsideratë nga të gjithë aktorët e përfshirë në sistemin e edukimit, pasi pasojat psikologjike dhe ato fizike mund të kenë

një kosto shumë të lartë për shoqërinë. Këmbana e alarmit bie kryesisht për aftësimin e mësuesve dhe prindërve në lidhje me praktikat e mira të komunikimit online, duke konsideruar dhe rezultatet e pyetjes së mëposhtme.

Pyetjes se kujt i jeni drejtuar për të kërkuar ndihmë për zgjidhjen e problemit që keni hasur, 40% e nxënësve pranojnë se i janë drejtuar vetë rrjetit social për të fshirë komentin apo vetë profilin fyes, ndërsa 35% e tyre u drejtohen miqve. Një përqindje e vogël 16% e të pyeturve u drejtohen prindërve, ndërkaq një përqindje akoma më e vogël i'u drejtohet organeve ligjzbatuese, si policia apo prokuroria. Në fund mbeten mësuesit, si alternativë për paraqitjen e shqetësimeve në rrjetin social.



Grafiku 11


Nga bisedat me nxënësit, u konstatua se mungesa e besimit nga ana e tyre për zgjidhjen e problemit nga ana e prindërve, organeve ligjzbatuese apo mësuesve vjen si rrjedhojë e mungesës së njohurive konkrete nga ana e këtyre të fundit për sa i përket komunikimit online. Aftësimi, kryesisht, i figurave të sistemit arsimor në këtë fushë bëhet e domosdoshme për të ardhmen e arsimit në Shqipëri.

Tre grafikët e mëposhtëm japin një panoramë të gjendjes aktuale të njohjes së të rinjve me politikat e privatësisë në rrjetet sociale, si dhe me praktikat e sigurisë, që ata përdorin për të qenë më të mbrojtur.

Pyetjes, “A keni njohuri mbi politikat e privatësisë në rrjetet sociale?”, 61% e të rinjve i është përgjigjur pozitivisht, ndërsa pjesa tjetër 39% e të pyeturve, ose nuk kanë njohuri fare, ose nuk janë të sigurtë për këtë. Për sa i përket pyetjes “A mendoni se politikat e privatësisë janë të shpjeguara mjaftueshëm në faqet e rrjeteve sociale?”, vetëm 39% e të rinjve është përgjigjur pozitivisht. Në grafikun e tretë shpjegojmë se vihet re se 59% e të rinjve kanë njohuri se si të ruajnë të dhënat e tyre personale gjatë përdorimit të internetit, 25% e tyre nuk i kanë këto njohuri. Madje, një pjesë më e vogël 16% e pjesëmarrësve në pyetësor, edhe pse kanë njohuri se si të mbrojnë të dhënat personale, nuk janë të interesuar për t’i mbrojtur ato.


Ndërgjegjësimi i nxënësve se të dhënat personale duhen mbrojtur nga keqpërdorimi i mundshëm i shokëve, të panjohurve apo keqbërësve të ndryshëm që afrohen online, duhet siguruar që të jetë një pjesë e pandashme e edukimit të tyre.

*A keni dijeni për politikat e privatësisë në rrjetin social ku jeni anëtarësuar?*



Grafiku 12


*A mendoni se politikat e privatësisë janë të shpjeguara mjaftueshëm në faqet e rrjeteve sociale ku jeni anëtarësuar?*



Grafiku 13



*A keni njohuri mbi masat e sigurisë së të dhënave personale në rrjetet sociale që përdorni?*



Grafiku 14


Ajo çfarë u vu re edhe gjatë bashkëbisedimit me nxënësit, ishte fakti se ata ndihen të pambrojtur kur vjen fjala për rastet e abuzimeve dhe problemeve që atyre mund t'u ndodhin online.

Një nga arsyet kryesore është dhe njohuria e pakët, që ata kanë për të drejtat e tyre dhe institucionet që mund t'i ndihmojnë në menaxhimin sa më të mirë të të dhënave për të minimizuar problemet me jetën e tyre personale.

Pyetjes, nëse kishin njohuri për Zyrën e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, si institucion të cilit ata mund t'i drejtohen në rastet e abuzimit me të dhënat personale, pak më shumë se gjysma e të pyeturve pranoi se kishte njohuri.

Rezultatet e kësaj pyetjeje mund të jenë të përmirësuara edhe për faktin se Zyra e Komisionerit ndër vite ka zhvilluar biseda me nxënësit e shkollave 9-vjeçare dhe të mesme. Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka marrë pjesë në edicionet e ndryshme të Panairit të Librit ku ka shpërndarë ligje, botime dhe fletëpalosje për të ndërgjegjësuar publikun me të drejtat e tyre, një pjesë të tyre do t'i gjeni në fund të këtij studimi.

*A e dini se ekziston dhe Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, ku mund të ankoheni në rast abuzimi me të dhënat personale?*



Grafiku 15

## Konkluzione

Rezultatet e pyetësorit tregojnë pa mëdyshje, se kjo grupmoshë e përdor masivisht internetin, ku kryesori është komunikimi nëpërmjet rrjeteve të ndryshme sociale. Aksesit në internet i lehtësuar sot nga përdorimi i telefonëve të zgjuar (smartphone), sjell padyshim avantazhe komunikimi dhe informimi për të rinjtë shqiptarë megjithëse mbart në vetvete disa rreziqe të dukshme lëndimi.

Kjo situatë kërkon shtimin e përpjekjeve nga ana e të gjithë aktorëve të përfshirë në mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve – prindër, mësues, psikologë, punonjës socialë, agjenci ligjzbatuese për një ambient digjital të sigurt – duke nxitur koordinimin e burimeve dhe shfrytëzimin e të gjithë instrumentave të nevojshëm në dispozicion për këtë qëllim.

Krijimi i këtij ambienti të sigurtë për një mbrojtje efikase të fëmijëve, paralelisht kërkon edhe përgatitjen apo ndërgjegjësimin e kësaj grupmoshe për të menaxhuar rreziqet e natyrave të ndryshme. Masat për rritjen e sigurisë synojnë parandalimin apo minimizimin e pasojave negative nga përdorimi i internetit në përgjithësi dhe rrjetit/rrjeteve sociale në veçanti.

Të dhënat e përfituara nga pyetësori tregojnë se koha e përdorimit të rrjeteve sociale zë një pjesë të konsiderueshme të aktivitetit të përditshëm të adoleshentëve. Nga ana tjetër, kjo marrëdhënie jo përherë ka të bëjë me detyrimet shkollore të të rinjve, edhe pse rrjetet sociale sot janë kthyer në platforma gjithëpërfshirëse komunikimi. Një shifër jo e parëndësishme, e cila duhet trajtuar me shqetësim si priorje është edhe niveli i përdorimit të lojërave online nga të rinjtë.

Ka një tendencë mes të rinjve për të patur sa më shumë llogari në rrjete të ndryshme sociale, si dhe një numër sa më të madh miqsh virtualë. Kjo prirje sjell shpesh problemin e mosnjohjes personale të të gjithë këtyre personave, çka përbën një kërcënim të drejtpërdrejtë për privatësinë e tyre dhe për mundësinë e shkakimit të shqetësimeve në jetën reale.

Me të rinjtë u trajtua gjerësisht tema e konflikteve që shfaqen midis tyre në rrjete sociale dhe rezultoi, se, në disa raste, çështjet u ishin referuar për zgjidhje edhe pse në numër të vogël organeve kompetente (policisë dhe prokurorisë). Nga ana tjetër, problemet e hasura preferohet më shumë të ndahen me miqtë se sa të zgjidhen me prindërit. Gjithashtu, konstatohet se të rinjtë kanë relativisht njohuri të mira për t'i raportuar problemet tek rrjeti social.

Nxënësit e shkollave të mesme kanë besim se problemi i hasur online mund të zgjidhet më shpejt dhe më mirë nga komunikimi i drejtpërdrejtë me kompaninë/rrjetin social ose me miqtë se sa me prindërit apo mësuesit.

Vetëm në 18% të rasteve të rinjtë u janë drejtuar këtyre të fundit. Një shpjegim i mundshëm lidhet edhe me faktin, se, në vendin tonë njohuritë e përdorimit të rrjeteve sociale gjenden më të shumta midis grupmoshave të reja dhe se besimi për të gjetur një zgjidhje të shpejtë të problemit është pikërisht tek ata që kanë më shumë njohuri.

Megjithëse, të vetëdijsëm për mbrojtjen e të dhënave të tyre personale, nxënësit shpesh tregohen neglizhentë për masat e sigurisë gjatë përdorimit të rrjeteve sociale. Kjo konstatohet edhe nga të dhënat e përftuara nga ky pyetësor për nivelin e konsiderueshëm të mosleximit apo moskuptimit të politikave të privatësisë. Ndoshta, një shpjegim mund të jetë barriera gjuhësore. Po ashtu, shifrat flasin se fyerjet apo ofendimet janë një fenomen i përhapur në këtë grupmoshë dhe se problematika duhet adresuar me përgjegjshmëri.

Gjetjet e këtij studimi synojnë të iniciojnë një diskutim gjithëpërfshirës mes disa institucionesh si Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Inovacionit dhe Administratës Publike, Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë, etj.

Adresimi i problematikave të kësaj grupmoshe të konstatuara edhe në këtë studim është i rëndësishëm për ta kthyer temën e privatësisë në pikë referimi, kur flasim për përdorimin e sigurt të internetit dhe rrjeteve sociale.

Diskutimi mund të jetë padyshim, si në rrafshin legjislativ dhe të hartimit të politikave strategjike, ashtu edhe në atë të zbatimit të masave konkrete. Besojmë se, avantazhet e aksesit në internet janë të shumta dhe përdorimi i tij dhe i pajisjeve të lidhura me të apo çdo lloj mjedisi digjital, do të rrisë në mënyrë të proporcionale si përfitimet edhe problematikat.

Ndaj besojmë se edhe në Shqipëri është koha e duhur për t'i trajtuar me përgjegjshmëri këto tema dhe për t'u dhënë atyre zgjidhjet më efikase.

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale e konsideron këtë fushatë të suksesshme duke konstatuar interesimin tejet të madh të nxënësve dhe mësuesve për temën e mbrojtjes së privatësisë dhe sigurisë në internet.

Në të ardhmen, Zyra e Komisionerit do të vazhdoj bashkëpunimin e saj me institucionet arsimore qendrore dhe lokale që të tilla iniciativa ndërjegjësuere dhe edukative, të shtrihen edhe në shkollat 9-vjeçare. Kjo sepse vërehet se ka një ndjeshmëri më të madhe ndaj këtyre problematikave për shkak të moshës më të vogël të nxënësve dhe njohja me praktikatat e mbrojtjes së privatësisë është më e ulët.

## Bibliografia

AKEP, Statistika, 2016 <http://akep.al/statistika>

EU Kids Online (2014) EU Kids Online: findings, methods, recommendations. EU Kids Online, LSE. <http://eprints.lse.ac.uk/60512/>

Hungarian National Authority for Data Protection and Freedom of Information, "Key to the world of the net. Study of NAIH on the safe and conscious internet use of children", 2013

Livingstone S., Ólafsson K., Staksrud E. "Social networking, age and privacy", EU Kids Online, London, UK. 2011 <http://eprints.lse.ac.uk/35849/1/Social%20networking%2C%20age%20and%20privacy%20%28LSERO.pdf>

Personal Data Protection Competency Framework for School Students, 38th International Conference of Data Protection and Privacy Commissioners. <https://icdppc.org/wp-content/uploads/2015/02/Resolution-2016-on-Privacy-education.pdf>

Përdorimi i internetit. Pajtimtarë, Akses dhe Volum 2010-2014, <http://open.data.al/sq/lajme/lajm/id/1583/Perdorimi-i-internetit.-Pajtimtare-Akses-dhe-Volum-2010-2014>, 2015

Resolution for the Adoption of an International Competency Framework on Privacy Education, 38th International Conference of Data Protection and Privacy Commissioners <https://icdppc.org/wp-content/uploads/2015/02/Resolution-2016-on-Privacy-education.pdf>

World Vision Albania "Siguria e fëmijëve online" Studim, 2014 <http://www.wvi.org/sites/default/files/Fact%20sheet%20shqip%20ok.pdf>

<https://www.statista.com/statistics/272014/global-social-networksranked-by-number-of-users/>  
[www.internetworldstats.com/stats9.htm#eu](http://www.internetworldstats.com/stats9.htm#eu)

**Këshilla për Mbrojtjen e Privatësisë nga  
Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit  
dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale  
dhe partnerë të tjerë**



## SUGJERIME PËR TË MBROJTUR PRIVATËSINË NË INTERNET

- Mendohu mirë përpara se të publikosh të dhënat e tua personale, sidomos emrin, adresën, numrin e telefonit, në një profil në rrjetet sociale.
- Mendo se fotografitë dhe informacionet që do të vendosësh në internet mund të rishfaqen pas shumë vitesh.
- Bëj kujdes kur jep informacione mbi shëndetin apo aspekte të jetës intime me miqtë virtualë, sepse mund të ketë "efekte anësore" në jetën tënde reale.
- Asnjëherë mos u ndje shumë i sigurt gjatë lundrimit në internet.
- Fotografitë dhe videot që shkëmbehen në mënyrë private me miqtë, mund të kopjohen ose të shpërndahen dhe tek të tjerët.
- Respekto të tjerët!  
Mos publiko informacione personale apo fotografi (as t'i bësh tag) pa marrë lejen e tyre.
- Nëse është e mundur, krijo pseudonime të ndryshme në rrjete sociale të ndryshme.





- Mos vendos asnjëherë ditëlindjen dhe informacione personale në pseudonimin tënd.
- Mos e përdor anonimitetin për të ofenduar. Nëse është e mundur, për të mbrojtur privatësinë tënde përdor pseudonime, por mos e përdor atë për të ofenduar të tjerët.
- Kërko që të dihet vendndodhja jote vetëm nga miqtë dhe familjarët.
- Çaktivizo funksionet e gjeolokalizimit, në mënyrë që të mos gjurmohesh nga të panjohur.
- Bëj kujdes me informacionet që jep në një rrjetet sociale apo aplikacion në telefonin tënd celular.
- Kontrolllo politikën e privatësisë së rrjetit social apo aplikacionit dhe përcakto rrethin më të ngushtë të miqve, të cilët mund të kenë akses në informacionet e tua.
- Më shumë informacione dhe këshilla rreth mbrojtjes së privatësisë, mund të gjeni në faqen zyrtare të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.





Bëni shumë kujdes në ruajtjen e informacionit personal në *smartphone* dhe *tablet* sepse këto të fundit mund të humbasin, të vidhen ose të sulmohen nga piratët elektronikë. Ju kurrë nuk duhet të mbani për shembull, fjalëkalimet, kodet e hyrjes dhe të dhënat bankare në mënyrë të dukshme. Nëse ju duhet të shisni apo dhuroni telefonin, merrni disa masa sigurie:

- Rivendosni parametrat e fabrikës;
- Hiqni kartën SIM dhe kartën e kujtesës;
- Fshini të gjitha *backups* të ruajtura në kujtesë.

### GJEOLOKALIZIMI

*Smartphone* dhe *tablet* kanë funksione gjeolokalizimi, por jeni ju ata që vendosni nëse, kur dhe kush mund të njohë pozicionin tuaj. Për të çaktivizuar gjeolokalizimin, ju mund t'i fikni parametrat përkatës të *smartphon-it* ose *tablet-ës* tuaj

## MBRONI TË DHËNAT TUAJA

**Vendosni** një PIN mjaft të komplikuar, duke shmangur, për shembull, të përdorni emrin tuaj, datën e lindjes, emrat e fëmijëve ose kafshëve shtëpiake, ose çfarëdo fjale tjetër që është lehtësisht e kopjueshme.

**Vendosni** një kod bllokimi që aktivizohet automatikisht kur telefoni është i ndezur por nuk është në përdorim për një kohë të caktuar. Gjithashtu, në këtë rast është mirë të shmangen kodet pak a shumë të lehtë për t'u zbuluar.

**Kujdes!** Ruani numrin IMEI, të cilin mund ta gjeni në kutinë e produktit që keni blerë dhe në rast të vjedhjes ose humbjes së aparatit tuaj *smartphone* ose *tablet* mund ta përdorni për ta bllokuar në distancë.

**Sigurohuni** që faqet e vizituara të përmbajnë protokollin e autentifikimit **https**. Kujdes të veçantë duhet pasur për sigurinë në përdorimin e faqeve bankare apo dhe emailit. Instaloni antiviruset.

Pas instalimit të një aplikacioni (app.), **kontrolloni** nëse kërkon qasje në përmbajtje të *smartphon-it* ose në *tablet*-ën tuaj (për shembull, foto apo kontaktet dhe lexoni me kujdes kushtet e përdorimit të shërbimit.

**Kujdes** nga *link-et* që ju shfaqen në email, mesazhe apo *chat*-e të ndryshme. Mund të përmbajnë viruse apo përmbajtje të tjera të padëshiruara.

Kjo broshurë është përgatitur në shembullin e fushatës ndërgjegjësuese të "Garante per la Privacy" "Fatti Smar".



## UDHËZUES PËR PUBLIKIMIN E FOTOVE TË FËMIJËVE NË INTERNET



*Me shumë mundësi, të gjithë ne kemi bërë foto të fëmijëve duke konsumuar tortë në një festë ditëlindjeje, ose lotët e tyre në ditën e parë të shkollës. Ne bëjmë foto se na duken argëtuese, sepse jemi krenarë dhe të kënaqur me pasardhësin tonë. Kështu, fiksojmë momentin që zgjat përgjithmonë dhe duam ta ndajmë atë me të tjerët.*

*Por, kohët ndryshojnë dhe kamerat e vjetra janë zëvendësuar me ato digjitale. Po ashtu edhe fotot në album janë zëvendësuar nga ato digjitale, të cilat i ruajmë në dosje në laptop-in apo kompjuterin personal. Ne mund edhe të bëjmë video me to dhe ta publikojmë atë në YouTube.*

*Teknologjia e re ofron mundësi dhe kënaqësi të pathëna. Por kjo do të thotë se ne si prindër apo si edukatorë në shkolla e kopshte, duhet të përballemi me probleme të reja. Duhet të bëjmë më shumë pyetje për të mbrojtur fëmijët tanë, të marrim masa paraprake për të ndaluar që persona të huaj në marrjen apo zotërimin e këtyre fotove. Duhet të jemi të vetëdijshëm, se fotot dhe videot e publikuara sot në internet, mund të kthehen e të na dëmtojnë në të ardhmen.*



*Ne të rriturit nuk e konsiderojmë aspak argëtues momentin kur mund të fotografohemi duke lotuar, ose kur na është nxirë njëri sy gjatë ndonjë zënke. Ashtu edhe fëmijëve nuk u pëlqen aspak nëse fotoja e tyre duke qarë, ose me hundët pis, publikohet në faqen e internetit të kopshtit. Ndonëse, fëmija është shumë i vogël për t'u lënduar sot, duhet të jemi të sigurt se pas disa vitesh, ai ose ajo, nuk do të dëshirojë që foto të tilla të ndahen (share)/të publikohen nga shokët apo bashkëmoshatarët. Fotot që publikohen sot në botën digjitale, do të jenë aty përgjithnjë, pavarësisht se fëmijët rriten. Pra, ne të rriturit e mbrojmë identitetin tonë, por duhet të jemi shumë të kujdeshshëm dhe të zellshëm në mbrojtjen e integritetit të fëmijëve tanë.*



**Udhëzime për prindërit:**

- Nëse dëshironi të publikoni fotografi të fëmijëve tuaj, përzgjidhni ato ku ata shfaqen nga sa më larg të jetë e mundur. Bëni foto në grup nga distanca të mëdha.
- Mos vendosni kurrë emra apo të dhëna të tjera identifikuese nëpër foto, pasi njerëzit që ju doni që t'i shohin i dinë detajet.
- Bëni foto të fëmijëve kur kryejnë aktivitete të ndryshme fizike. Të tilla foto janë më pak tërheqëse për abuzuesit.
- Evitoni bërjen e fotove të fëmijëve të zhveshur apo pjesërisht të veshur.
- Evitoni bërjen e fotove me karakter sensual, apo që e sygjerojnë diçka të tillë.
- Nëse publikoni foto në ndonjë faqe, sigurohuni që albumi të ketë fjalëkalim.



#### **Udhëzime për edukatorët:**

- *Lërimi të tjerët të inspektojnë dhe vlerësojnë fotot përpara publikimit ose përdorimit për qëllime të tjera.*
- *Tregohuni të kujdesshëm në rastet kur fotot tregojnë fëmijët, stafin dhe kopshtin apo shkollën tuaj.*
- *Merrni në konsideratë mundësinë e pajisjes me leje nga prindërit të fëmijëve të pajisur me kamera apo foto-aparate.*
- *Komunikoni me prindërit për mënyrën se si fëmijët i përdorin fotot e bëra në shkollë apo në aktivitete shkollore për qëllime të tjera.*
- *Hartoni një formë standarde pëlqimi, që të mund ta përdorni për rastet kur mendoni se është e nevojshme.*
- *Ndërroni rregullisht fjalëkalimin e faqes tuaj në internet.*
- *Nxisni prindërit që të tregojnë nëse është publikuar diçka (foto) që atyre nuk u pëlqen.*
- *Stafet edukative të çerdheve, kopshteve dhe shkollave duhet të jenë të vetëdijshëm se fotot e marra nën drejtimin e tyre, janë përgjegjësi e tyre.*



#### **Tema për diskutim me prindërit**

- *A jeni të informuar mjaftueshëm për të përdorur teknologjinë e re në mënyrë që të shmangni abuzimet?*
- *A keni menduar se të tjerët mund të abuzojnë me fotot e fëmijëve tuaj?*
- *A mendoni se mund t'i zëvendësoni fotot e fëmijëve me foto të tjera, që tregojnë aktivitetin por jo fytyrat?*
- *A mund të rigjykoni nëse duhet t'i mbani të publikuara foto të caktuara të fëmijëve tuaj? Madje, të merrni në konsideratë edhe faktin që do ishte më mirë t'i fshihnit?*




Tema për diskutim me edukatorët dhe mësuesit:

- Si mund ta nxisim dialogun me prindërit rreth përdorimit të sigurt të fotove, për të rritur ndërgjegjësimin për mënyrën se si i përdorim fotot e fëmijëve midis nesh?
- A mund të hartojmë një program edukativ rreth përdorimit të kamerave (foto-aparataeve) dhe fotove për përfitimin e fëmijëve dhe ndoshta, më shumë për atë të prindërve?
- A është mjaftueshëm i sigurt fjalëkalimi për faqen tonë (llogarinë në rrjetin social), duke marrë parasysh numrin e lartë të përdoruesve të internetit?
- A mund të zëvendësojmë albumet online me disa mënyra të tjera prezantimi?

*Ky material është përshtatur nga publikimi i Autoritetit norvegjez të Mbrojtjes së të Dhënave Personale me titull "Good intentions... A guide to the publication of images of children online".*

*Në këtë material janë përdorur edhe punime pjesëmarrëse në konkursin "Mburo privatësinë tënde gjatë lundrimit në internet" me nxënës të shkollave 9-vjeçare të vendit.*



KOMISIONERI PËR TË DREJTËN  
E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN  
E TË DHËNAVE PERSONALE



KOMISIONERI PËR TË DREJTËN  
E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN  
E TË DHËNAVE PERSONALE



KOMISIONERI PËR TË DREJTËN  
E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN  
E TË DHËNAVE PERSONALE

**REPUBLIKA E SHQIPERISË**  
Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe  
Mbrojtjen e të Dhënave Personale



**UDHËZUES  
PËR PËRDORIMIN E  
“RRJETEVE SOCIALE” ONLINE**

**KËSHILLA SE SI TË MBRONI  
PRIVATËSINË TUAJ**



## ÇFARË JANË “RRJETET SOCIALE”?

Network-ët social si Facebook, MySpace dhe të tjerë janë “sheshe virtuale”, pra vende ku fal internetit mund të futësh dhe të ndash me të tjerët fotografi, filmime, mendime, adresa të miqëve e shumë të tjera. Rrjetet sociale janë instrumentet më të përsosura për ndarjen e informacionit me të tjerë dhe përfaqësojnë një formë të shkëlqyer komunikimi edhe pse përbëjnë rrezik për sferën personale të individëve që janë përfshirë në të.

Facebook, për të përmendur një prej më të njohurave, në fillimet e tij ishte ekzaktësisht përkthimi virtual i “librit të fotografive të shkollës” që mbahej çdo vit. Një tabelë lajmërimesh telematike ku mund të gjesh kolegët e kursit dhe të shkëmbesh informacione me ta. Zhvillimet e fundit po i shtojnë “rrjetet sociale” të integrohen gjithmonë e më shumë me telefonat celular, duke transformuar mesazhet që publikojmë on-line në një lloj mesazhi të shumëfishhtë që u shkon në të njëjtin moment të gjithë miqve tanë.

## DISA NGA RRJETET SOCIALE MË TË PËRHAPUR NË BOTË

Facebook, MySpace, Hi5, Flickr, Skyrock, Friendster, Tagged, LiveJournal, Orkut, Fotolog, Bebo.com, LinkedIn, Badoo.Com, Multiply, Imeem, Ning, Last.fm, Twitter, MyYearbook, V Kontakte, aSmallWorld, Windows Live, Xiaonei.

## DISA KËSHILLA PËR KATEGORI TË VEÇANTA TË PËRDORUESVE TË RRJETEVE SOCIALE





## JENI NJË PËRDORUES I "RI"?

- Nëse do kishit djeni se fqinji apo profesori juaj mund të lexonte informacionet që keni publikuar online, a do ti publikonit ato në profilin tuaj?
- A jeni të sigurtë se do t'ju pëlqente ti gjenit fotot dhe informacionet tuaja ende të publikuara online edhe pas disa vitesh?
- Përpara se të postoni "foton gazmore" të një miku, a e keni pyetur veten nëse do t'ju pëlqente të gjendeshit në të njëjtën situatë?
- Anëtarët e grupit tek i cili jeni regjistruar, a mund të lexojnë informacionet tuaja personale?
- Jeni të sigurt që do t'ia tregonit "atë" foto të publikuar edhe të dashurit/dashurës tuaj të re?



## JENI PRIND?

- A i keni shpjeguar fëmijës tuaj se nuk duhet të preki sobën kur ajo është e ndezur, se si të kalojë rrugën kur është vetëm, të "mos marri karamele nga persona të panjohur" ... por a e keni mësuar të njohi sinjalet e rrezikut në internet?
- A i keni mësuar të mbrohet nga sulmet e provokuesve të mundshëm online? Të mos u tregoj të panjohurve jetën e tij private dhe atë të miqve të tij?
- Keni provuar ndonjëherë të hyni bashkë me fëmijën tuaj në internet? I keni kërkuar t'ju tregojë se si përdoret interneti? Në cilat grupe është regjistruar?
- A e keni pyetur nëse ka qenë ndonjëherë viktimë e "cyberbulling" (akteve të dhunshme të ushtruar ndaj tij nga bashkëmoshatarët nëpërmjet mjeteve elektronike)?




## NËSE KËRKONI PUNË

- A e dini që kompanitë kur zgjedhin personelin kërkojnë informacione për kandidatët të cilët dëshirojnë të punësojnë duke përdorur motorët kryesor të kërkimit online?
- A e dini se fotot që keni publikuar në "rrjete sociale" dhe postimet e

ndryshme që keni bërë aty mund t'ju dëmtojnë në kërkimin për punën tuaj të ardhshme?

- A korrespondon CV-ja, që keni dërguar tek një kompani për aplikim pune, me atë që keni vendosur në internet?
- A janë koherente ato që tregoni rreth vetes tuaj gjatë "bisedave online" me aspiratat profesionale që keni?



## JENI PËRDORUES "EKSPERT"?

- A keni verifikuar çfarë niveli privatësie ka identiteti juaj i publikuar online?
- A e keni dhunuar të drejtën e privatësisë së dikujt duke publikuar "atë" material?
- A keni bërë ndonjëherë gabimin duke ua treguar "ato" foto të tjerëve, kur i ke postuar?
- A e keni verifikuar kush e mban "licencën e përdorimit", "të drejtën e autorit" dhe "pronësinë intelektuale" të dokumentave, të imazheve ose të video-ve që keni publikuar online?



## JENI NJË "PERSON NË KARIERË"?

- A jeni në dijeni nëse grupi i personave, që kanë akses për të ndërvepruar me identitetin tuaj, korrespondon me qëllimin profesional që i keni vënë vetes synim për të arritur?
- A e dini se regjistrimi në grupe të caktuara në "rrjete sociale" mund të sjellë pasoja negative në punën tuaj?
- Nëse krijoni një konflikt online me një anëtar tjetër të "rrjetit social" tek i cili jeni regjistruar, a jeni të përgatitur të reagoni në mënyrën e duhur?
- A e keni vlerësuar faktin se po "ndani" informacione me dikë që mund t'ju dëmtojë?
- A e dini që shërbime të shumta "chat" (komunikime elektronike) duke përfshirë edhe ato të ofruara nga website-et e "rrjeteve sociale", mundësojnë regjistrimin dhe ruajtjen e përmbajtjes së bisedës të zhvilluar me përdoruesit e tjerë?



## KËSHILLA PËR NJË PËRDORIM TË NDËRGJEGJSHËM TË RRJETIT SOCIAL

### TË RESPEKTOSH TË TJERËT!

Mos publikoni asnjëherë informacione personale dhe foto të personave të tjerë pa pëlqimin e tyre. Mund të rrezikoni edhe sanksione penale.

### KONTROLLO VETEN!

Mendo mirë para së të publikosh të dhënat e tua personale, mbi të gjitha emrin, adresen, numrin e telefonit në një profil përdoruesi, apo të pranosh me lirshmëri kërkesat për miqësi.

### KUJDES!

Duhet të keni kujdes pasi fotot dhe informacionet e publikuara dikur, mund të rishfaqen falë motorëve të kërkimit (google, yahoo etj.) në distancë vitesh.



## Privatësia dhe siguria e të dhënave personale gjatë përdorimit të rrjeteve sociale

### PSEUDONIMI

Nëse është e mundur krijoni pseudonime të ndryshme në secilin nga rrjetet ku jeni regjistruar. Mos përdorni datëlindjen apo informacione të tjera personale në "nickname" (pseudonim) e krijuar.

### TË NDRYSHOSH LOGIN DHE PASSWORD

Përdorni emër përdoruesi dhe password të ndryshëm nga ato të përdorura në faqe të tjera web-i për postën elektronike dhe për menaxhimin e llogarisë tuaj bankare online.

### MIRËINFORMOHU!

Sa herë bëheni përdorues i një "rrjeti social" informohuni se kush e menaxhon atë shërbim dhe çfarë garancie ofrohet në trajtimin e të dhënave personale. Kujtoni se keni gjithmonë të drejtën të dini në ç'menyrë ju përdoren të dhënat. Kërkoni informacion në rubrikat përkatëse "privacy" dhe "privacy policy".



### NIVELI I PRIVATËSISË

Përdorni parametrat e këshilluara të privatësisë, duke kufizuar në maksimum gatishmërinë në dhënie dhe informacionit, mbi të gjitha përsa i përket rishfaqjes së të dhënave me anën e motorëve të kërkimit (google, yahoo etj.).

Kontrolloni çfarë niveli privatësie ka profili juaj: kush mund tju kontaktoj, kush ka akses për të lexuar ato që shkruani, kush mund të fusë komente në faqen tuaj të profilit, çfarë të drejtash zotërojnë antarët e grupeve të "Rrjeteve sociale" ku jeni regjistruar.

Ju mund të kontaktoni me: Zyrën e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale

# PRIVATËSIA DHE SIGURIA E TË DHËNAVE PERSONALE

GJATË PËRDORIMIT TË RRJETEVE SOCIALE  
NGA GRUP-MOSHA 15-18 VJEÇ

Studim



KOMISIONERI PËR TË DREJTËN  
E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN  
E TË DHËNAVE PERSONALE

info@idp.al  
+355 42237200  
08002050

Tiranë

www.idp.al